



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2019/2 prot.,

Datë 23.07.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË  
PERATORIT EKONOMIK ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E  
OFERTUESVE TË TJERË**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-05116-05-16-2024, me objekt: “Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)”, me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Mbetjen të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATOM” SHPK, nga operatori ekonomik “C.C.S” SHPK dhe nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK, me NIPT: J61817047D dhe me adresë: *Bulevardi “Zhan D’ark”, Ndërtesa 32, Hyrja 16, Kati II, Ap.1, Tiranë*

**Autoriteti kontraktor:**

Bashkia Shkodër  
*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër.*

**Subjekte të Interesuara:**

Operatori ekonomik “ATOM” SHPK me NIPT: L22203042N dhe me adresë: *Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga “Islam Alla”, Pallati Nr.56, Kati i 1, Tiranë.*

Operatori ekonomik “C.C.S” SHPK me NIPT: J61901033C dhe me adresë: *Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Sulejman Delvina”, nr.8, kodi postar nr.1019, Tiranë.*

Operatori ekonomik "INSTANT.AL" SHPK me NIPT: L81506043D dhe me adresë: Rruga "Ali Demi" përballë "Fushës së Zezë", zona kadastrale 8150 ,numri i pasurisë 8/801-B1, Tiranë.

Në datën 22.07.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2024/4352 datë 22.05.2024, dhe me nr. 2019/2024 prot, datë 22.07.2024 e operatorit ekonomik "KLAME" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-05116-05-16-2024, me objekt: "Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)", me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "BNT ELECTRONICS" SHPK.

Gjithashtu operatori ekonomik "BNT ELECTRONICS" SHPK, kërkon mbetjen të skualifikuar për arsyet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave, të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "ATOM" SHPK, nga operatori ekonomik "C.C.S" SHPK dhe nga operatori ekonomik "INSTANT.AL" SHPK, në këtë procedurë prokurimi.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma "b" dhe "c" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: "Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime."

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik "BNT ELECTRONICS" SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me nr. 2019 protokoll, datë 22.07.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

"Operatori ka mosperputhje te specifikimeve teknike te paraqitura ne oferten teknike me ato te paraqitura ne broshura sipas kriterit 2.3.3. Nuk permendet sistemi i operimit ne modulim e integruar smart ops. Kriteri Media Device: DVD+/-RË ne paisjet kompjuter nuk eshte i permendur. Tek produkti router nuk permendet menyra e operimit Access point mode Media. Tek

*Printerat MFP Color Basic 25000 kopje/muaj, MFP B&Ë copy Machine Basic 100,000 kopje/muaj, MFP B&Ë copy Machine A4 5000 kopje/muaj dhe MFP B&Ë copy Machine Basic 25,000 kopje/muaj nuk permendet cikli mujor i punes.”.*

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK, kërkon mbetjen të skualifikuar për arsyet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave, të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATOM” SHPK, të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “C.C.S” SHPK dhe të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, në këtë procedurë prokurimi.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 23.07.2024.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**